



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KUCOVE

Njësia e Auditimit të Brendshëm

KARTA E AUDITIMIT TE BRENDSEHEM

Neni 1

Objekti i Kartës së Auditimit

Karta e Auditimit të Brendshëm, e cila hartohet në zbatim të ligjit nr.114/2015 datë 22.10.2015 “*Auditimi i Brendshëm në sektorin publik*” i ndryshuar dhe Urdhrit të Ministrit të Financave nr.100 datë 25.10.2016 “*Miratimi i Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*”, është dokumenti zyrtar që përshkruan qëllimin, autoritetin dhe përgjegjësitë e auditimit të brendshëm të përcaktuara në standartet ndërkombëtare për praktikën profesionale të kësaj veprimtarie. Karta formalizon dhe përforcon pozicionin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm si njësi (sektor) brenda Bashkisë Kucovë, autorizon drejtuesin dhe stafin e njësive të auditimit, të kenë të drejtën dhe përdorim të pakufizuar mbi çdo dokument të informacioni zyrtar, pronë dhe personel, të cilat kanë lidhje me performancën e angazhimit, si dhe përcakton objektin e veprimtarive të auditimit të brendshëm.

Kryetari i Bashkisë apo Komiteti i Auditimit (në rast se ky organ funksionon) ka të drejtën për aprovimin përfundimtar të Kartës së Auditimit të Brendshëm.

Në objektin e Kartës së auditimit të brendshëm, sikurse parashikohet në ligjin e auditimit të brendshëm, përfshihen shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e keshillimit, të cilat i ofrohen bashkisë Kucovë. Ky dokument luan rol të rëndësishëm në përmbushjen e objektivave të veprimtarisë audituese.

Neni 2

Baza ligjore

Veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në bashkinë Kucovë, do të kryhet bazuar në aktet ligjore e nenligjore :

- Aktet ligjore e nenligjore të **Vetëqeverisjes Vendore** (në përditësim) ;
- Aktet ligjore e nenligjore të **Auditimit të Brendshëm** në sektorin publik (në përditësim) :
 - Ligji nr.114/2015 dt.22.10.2015 “*Auditimi i Brendshëm në sektorin publik*”, ndryshuar
 - Urdhri i Ministrit të Financave nr.100 dt.26.10.2016 “*Miratimi i M.A.B* “
 - Urdhri i Ministrit të Financave nr,86 dt.10.12.2015 “*Miratimi i Kodit të Etikës*”
 - VKM nr.83 dt.3.02.2016 “*Krijimi i Njësive të A.B në sektorin publik*”

- VKm nr.160 dt 2.03.2016 “*Funksionimi, kompetencat, perberja e Komitetit te Auditit te brendshem ne sektorin publik*”.

Neni 3

Statusi Organizativ :

Struktura dhe organizimi i Njesisë se Auditimit te Brendshem miratohet me Urdher te Kryetarit te Bashkisë si pjese perberese e strukture administrative te Bashkisë Kucove. Kjo njesi eshte organizuar si Sektor me vete, ne varesi te drejtperdrejt organizative dhe funksionale nga Kryetari i Bashkise dhe ka ne perberje 3 punonjes te strukturuar : 1(nje) Pergjegjes i sektorit dhe 2(dy) specialist auditues te brendshem.

Per veprimtarine e saj, planifikimin e angazhimeve te auditimit, gjetjet e rekomandimet e dhena, ky Sektor raporton drejtperdrejt te Kryetari i Bashkise, i cili eshte niveli me i larte i drejtimit ne njesite qe auditohen.

Punonjesit e Sektorit te Auditimit te Brendshem nuk angazhohen ne detyra te tjera brenda bashkise, te cilat nuk lidhen me funksionimin e auditimit te brendshem, pasi nuk jane pjese e strukturave operacionale te bashkise Kucove.

Neni 4

Misioni dhe Qellimi i Sektorit te Auditimit te Brendshem

- Misioni:

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të pavarur dhe të arsyeshme dhe të ofrojë shërbime këshillimi, për t’i shtuar vlerë Bashkise Kucove dhe për të përmirësuar veprimtarinë dhe sistemet e kontrolleve të brendshme të kesaj bashkie .

Çdo angazhim auditimi kryhet në përputhje me aktet ligjore nënligjore në fuqi, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar dhe shpallura nga Ministri i Financave, të planit të konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në bashki. Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësive të tyre, nëpërmjet analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve , lidhur me veprimet e ekzaminuara.

- Qellimi :

Qëllimi i auditimit të brendshëm është të ndihmojë Kryetarin e Bashkise Kucove të arrijë objektivat dhe të përmbushë me efektivitet përgjegjësitë e veta, duke përdorur një metodë sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe përmirësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e proceseve të administrimit të rrezikut, e proceseve të kontrollit dhe proceseve të qeverisjes.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm kryhet duke respektuar përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë. Këto udhëzues, përbëjnë parimet dhe kërkesat themelore për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, në vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrolleve të brendshme dhe performancës së veprimtarisë audituese.

Veprimtaria e auditimit të brendshëm do t'i përmbahet edhe politikave, procedurave metodave të auditimit, si pjesë e manualit standard të auditimit të brendshëm

Neni 5

Objekti i punës dhe Fusha e Veprimit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm

- Objekti i Punës :

Objekti i punës së Sektorit të auditimit të brendshëm konsiston në:

- Identifikimin dhe vlerësimin e riskut, duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të riskut.
- Vlerësimin e kontrolleve të cilat adresojnë riskun.
- Inkurajimin e kontrolleve efektive dhe efëçente dhe nxitjen për përmirësim të vazhdueshëm.
- Vlerësimin dhe pasqyrimin e procesit që siguron besueshmëri dhe integritet të informacionit financiar dhe operacional.
- Rekomandimin e përmirësimit të kontrolleve në ndihmë të procesit të qeverisjes.

- Fusha e veprimit :

Fusha e veprimit për Sektorin e AB duhet të jetë mjaftueshëm e plotë për të mundësuar ekzaminimin efektiv dhe të rregullt të të gjithë veprimtarive operacionale, financiare dhe të lidhura, si dhe cilësinë e performancës për kryerjen e përgjegjësi të caktuara për të arritur qëllimet dhe objektivat e deklaruara të bashkise. Kjo përfshin:

- Vlerësimin e ekspozimit të riskut në lidhje me arritjen e objektivave strategjike të njësisë.
- Vlerësimin e besueshmërisë dhe integritetin e informacionit dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matjen, klasifikimin, dhe për të raportuar një informacion të tillë.
- Vlerësimin e sistemeve të vendosura për të siguruar përputhjen me ato politika, plane, procedura, ligje dhe rregullore të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në njësinë.
- Vlerësimin e efektivitetit dhe efikasitetin me të cilën burimet janë përdorur.
- Vlerësimin e mjeteve dhe ruajtjen e pasurisë sipas nevojës, verifikimin e ekzistencës së aktiveve të tilla.
- Vlerësimin e operacioneve apo programeve për të vërtetuar nëse rezultatet janë në përputhje me objektivat dhe synimet e vendosura.
- Kryerjen e konsultimit dhe shërbimeve këshilluese në lidhje me menaxhimin e riskut dhe kontrollin, si objektiva të përshtatshme për njësinë.
- Raportimin periodik për veprimtarinë e auditimit të brendshëm, mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe performancën në lidhje me planin e tij.

Veprimtaria e Sektorit të AB udhëhiqet gjithashtu nga respektimi i udhëzimeve të detyrueshme, përfshirë, Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm të publikuara nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA) dhe të pranuar për t'u zbatuar në Republikën e Shqipërisë, si dhe zbatimi i kriterëve të mirepërcaktuara në Kodin e Etikës për punonjësit e auditimit të brendshëm i miratuar me urdher të Ministrit të Financave. Përveç kësaj, veprimtaria e auditimit të brendshëm i përmbahet, politikave, procedurave dhe metodave të auditimit, si pjesë e manualit standard të auditimit të brendshëm.

Neni 6

Te drejtat dhe pergjegjesite e Sektorit te Auditimit te Brendshem

6.1 Autoriteti :

Ne mbeshtetje te ligjit “Per veteqeverisjen Vendore” dhe ne funksion te ligjit “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, Kryetari i Bashkise Kucove, duhet t’i garantoje Sektorit te Auditimit te Brendshem burimet e nevojshme lidhur me stafin dhe kushtet te tjera te nevojshme per te realizuar auditime te pavarura dhe me cilësi, njeheresh ti siguroje autoritetin per :

- Të kryejë auditime në pajtim me programin e aprovuar.
- Me urdhër të Titullarit, Sektori i Auditimit kryen auditime të plota ose për sisteme të veçanta kontrolli edhe jashtë planit vjetor të miratuar.
- Të ketë akses në të gjitha periudhat e veprimtarise së subjektit dhe në të gjithë rregjistrat, dokumentat, llogaritë, korrespondencën, asetet fizike dhe të dhëna të tjera të subjektit që ai i çmon të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit.
- Të kërkojë informacion nga çdo i punësuar i subjektit që auditohet kur gjykohet se një gjë e tillë duhet për të forcuar një opinion mbi ndershmërinë dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit.
- Gëzon prioritet nga menaxhimi i të gjitha niveleve për diskutime relevante me çështje që lidhen me auditimin e subjektit.

6.2 Pavaresia:

Punonjesit e Sektorit te Auditimit te Brendshem kane pavaresi funksionale dhe organizative.

- Pavarësia Funksionale nënkupton se strukturat e auditimit janë të pavarura në planifikimin, kryerjen dhe raportimin e rezultateve të auditimit nga subjekti që auditohet.
- Pavarësia Organizative brenda njësisë nënkupton që specialistet e auditimit te brendshem raportojne te Pergjegjesi i Sektorit te Auditimit te Brendshem dhe nepermjet tij, raportohet drejperdrejt te Kryetari i Bashkise. Ata nuk mund të angazhohen në detyra të tjera brenda njësisë të cilat nuk lidhen me funksionimin e auditimit të brendshëm.
- Audituesit e Brendshëm duhet te mbajne qendrim te paanshem dhe ti shmangen konfliktit te interesit.

6.3 Kufizimet :

Pergjegjesi i Sektorit dhe stafi i auditimit te brendshem nuk jane te autorizuar :

- Te kryejne detyra operationale brenda Bashkise Kucove, apo në institucionet e vartësisë..
- Te jene te zgjedhur ne strukturat drejtuese te partive politike.
- Te ushtrojne çdo veprimtari ose pune tjetër me pagese, ose te kene perfitime te tjera, te natyrave dhe formave qe i bejne te jene ne konflikt interesash me ushtrimin e auditimit.
- Të krijojnë ose miratojnë transaksione të llogarisë që janë jashtë Njësisë së Auditimit të Brendshëm.
- Të drejtojnë veprimtaritë e punonjësve që nuk janë punësuar nga njesia e Auditimit të Brendshëm, përveçse kur këta punonjës janë caktuar në grupet e auditimit sipas nevojës, ose në ndonjë mënyrë tjetër për të ndihmuar Audituesit e Brendshëm.

6.4 Pergjegjshmeria :

Pergjegjesi i Sektorit te Auditimit te Brendshem në përmbushjen e detyrave të veta, është përgjegjës përpara menaxhimit që :

- Të japë vlerësime vjetore per Kryetarin e Bashkisë, mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të risqeve te rendesishem, dhe për objektin e dokumentuar të punës audituese.
- Të raportojë rregullisht për dobësitë thelbësore të identifikuara nga auditimi, sëbashku me rekomandime për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm.
- Të informojë periodikisht menaxhimin e lartë (Kryetarin e Bashkise) e Drejtorine e Harmonizimit te Auditimit te Brendshem(Ministria e Financave) mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Sektorit te A.B.
- Te raportoje per rezultatet e sherbimit keshellimor dhe konsulences per menaxhimin e larte, si nje nga detyrat e tij te ngarkuara me ligj.
- Të koordinojë dhe mbikëqyrë funksionet e tjera të kontrollit dhe ato monitoruese (menaxhimin e riskut, përputhshmërinë, sigurinë, ligjshmërinë, etikën, mjedisin, auditimin e jashtëm).

6.5 Pergjegjesia :

Përgjegjësi i Sektorit te Auditimit te Brendshem, ka keto pergjegjesi :

- Hartimin e planeve vjetore dhe strategjike për veprimtarinë e Sektorit te Auditimit të Brendshëm ne strukturat e Bashkisë Kucove;
- Hartimin e planit vjetor elastik për auditimin e brendshëm, bazuar ne metodologjinë e vleresimit te riskut, duke perfshire risqet e kontrollit te brendshem te sugjeruara nga menaxhimi, dhe te paraqese keto plane per miratim Kryetarit të Bashkisë.
- Zbatimi i planit vjetor të auditimit siç është miratuar, dhe realizimi i auditimive shtese të kërkuar nga menaxhimi, i miratuar paraprakisht nga Kryetari e Bashkisë Kucove dhe detyrimisht i percjelle per informim ne D.H/A.B(Min.Financave);
- Ndjek dhe vlerëson zbatimin e rekomandimeve të auditimit te brendshem nga subjektet e audituara;
- Përgatitjen e raporteve vjetore dhe periodike te veprimtarise se Sektorit te Auditimit te Brendshem, dhe pas miratimit te tyre nga Kryetari i Bashkise, ti dergoje brenda afatit te percaktuar me ligj per raportim dhe vleresim ne D.H/A.B(Min.Financave);
- Angazhimin per te mundesuar nje staf auditues me nivel profesional dhe me njohuri të mjaftueshme, aftësi, përvojë dhe çertifikime profesionale në përmbushje me kërkesat e kësaj Karte.
- Ndertimin e programit te sigurimit të cilësisë me anë të së cilit sigurohet funksionimi i veprimtarisë audituese.
- Kryerjen e shërbimit te konsulences krahas shërbimeve për dhënien e sigurisë dhe te asistojë menaxhimin në arritjen e objektivave.
- Ti konsiderojë fushat/sistemet e mbuluara nga Auditimi i Jashtem, me qellim qe te garantoje mbulimin sa me optimal me auditim te fushave te tjera, me nje kosto te arsyeshme.

- Hartimi i raporteve periodike për Kryetarin e Bashkisë ku të jepen të përmbledhura rezultatet e veprimtarisë së auditimit dhe tendencat e lindura dhe praktikrat e suksesshme në Auditimin e Brendshëm.

Pergjegjesite e Audituesve te brendshëm

Përgjegjësitë e audituesve të brendshëm janë:

- a) të njohin, të respektojnë dhe të ushtrojnë veprimtarinë audituese në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare, të pranuar, të auditimit të brendshëm;
- b) të ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë objektive dhe me profesionalizëm;
- c) të veprojnë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kodin e Etikës, Kartën e Auditimit dhe rregullat për konfidencialitetin për audituesin e brendshëm;
- ç) të kryejnë auditime në mënyrë të pavarur, duke u udhëhequr nga interesi publik, për të forcuar besimin në ndershmërinë, paanësinë dhe efektivitetin e shërbimit;
- d) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar;
- dh) të përditësojnë rregullisht njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që t'i përdorin ato me efikasitet dhe për të garantuar cilësinë e shërbimit;
- e) të japin rekomandime për njësinë e audituar për përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe për masat që duhen ndërmarrë në rastet e konstatimit të dëmeve ekonomike e financiare për zhdëmtimin e tyre dhe për të ulur mundësinë e përsëritjes;

• Neni 7

Plani i auditimit të brendshëm

- Në konsultim paraprak me Kryetarin e Bashkisë dhe Komitetin e Auditimit (nese eshte ngritur), drejtuesi i Sektorit te AB, çdo vit, paraqet pranë Titullarit një plan auditimi të brendshëm për shqyrtim dhe miratim. Plani i auditimit të brendshëm jep një informacion mbi punën që do të kryejë auditimi gjatë një viti, dhe përfshin kërkesat për buxhetin dhe burimet që do të përdoren gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.
- Drejtuesi i Sektorit te AB komunikon ndikimin e kufizimeve të burimeve, si dhe ndryshimet e rëndësishme të planit i prezanton tek Titullari dhe Komiteti i Auditimit (nese eshte ngritur) .
- Plani i auditimit të brendshëm zhvillohet në bazë të prioritetit të universit të auditimit, duke përdorur një metodologji që bazohet në vlerësimin e riskut, duke përfshirë edhe kontributin e menaxhimit të lartë dhe KA.
- Drejtuesi i Sektorit te AB, shqyrton dhe rregullon planin, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve të aktivitetit të njësisë, risqeve, operacioneve, programeve, sistemeve dhe kontroleve. Çdo devijim i rëndësishëm nga plani i aprovuar i auditimit të brendshëm bëhet me miratim të Titullarit dhe Komitetit të Auditimit përmes veprimtarisë raportuese periodike.

Neni 8

Raportimi dhe monitorimi

- Në përfundim të çdo angazhimi përgatitet një raport i shkruar auditimi, i cili i dërgohet subjektit të audituar.
- Raporti i auditimit prezanton fushën e auditimit, kufizimet eventuale, zbulimet dhe konkluzionet në mënyrë objektive si dhe adreson rekomandimet përkatëse për permiresim.
- Auditimi i brendshëm ka një status raportimi të pavarur brenda subjektit çka presupozon që raportet e tij i përcillen drejtpërdrejt tek Kryetari i bashkise..
- Rezultatet e auditimit të brendshëm duhet t'i komunikohen periodikisht Komitetit të Auditimit (nese ky organ eshte ngritur).
- Sektori i AB është përgjegjëse për raportimin e të gjitha gjetjeve gjatë angazhimit tek menaxheri i njësisë se audituar dhe te titullari i bashkise dhe të raportoje zbatimin e rekomandimeve nga subjekti i audituar apo strukturat e ngarkuara nga titullari për zbatimin e këtyre rekomandimeve.
- Raporti i auditimit të brendshëm përfshin përgjigjet dhe veprimet korrigjuese të ndërmarra nga menaxhimi i subjektit të audituar ose kerkesen per ndertimin e Plan Veprimit per masat që do të merren në lidhje me zbatimin e rekomandimeve specifike.
- Drejtuesi i Sektorit te AB-së raporton periodikisht tek Kryetari i bashkise dhe Komiteti i Auditimit(nese eshte ngritur), mbi veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm, përgjegjësitë, si dhe performancën e saj. Raportimi përfshin ekspozimet ndaj risqeve dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë edhe risqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes, si dhe çështje të tjera të nevojshme apo të kërkuara nga Titullari .

Neni 9

Ndjekja e rekomandimeve

Sektori i AB harton procesin e ndjekjes së rekomandimeve për të monitoruar dhe për t'u siguruar që veprimet korrektive janë implementuar dhe janë efektive.

Gjithashtu Sektori i AB i percjell rekomandime titullarit për adresimin në strukturat përkatëse brenda bashkise të rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të kontrollit që nuk varen nga subjekti i audituar dhe bën ndjekjen e zbatimit të tyre.

Titullari i subjektit të audituar është përgjegjës për të vlerësuar domosdoshmërinë e veprimeve korrektive që duhet të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve për dobësitë e zbuluara. Ai duhet të njoftojë me shkrim Sektorin e AB brenda 30 ditëve nga njohja me raportin përfundimtar të auditimit, lidhur me pranimin dhe masat konkrete të marra për zbatimin e tyre.

Sektori i AB bën vlerësimin dhe verifikimin e përgjigjeve të menaxherit të subjektit të audituar si dhe informon titullarin e bashkisë periodikisht për përgjigjet e marra apo pranimin e riskut nga njësiat e audituar.

Neni 10

Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit

Sektori i A.B do të mbajë një program të sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit që mbulon të gjitha aspektet e aktivitetit të auditimit të brendshëm, i cili miratohet me urdhër të Kryetarit te bashkise. Programi do të përfshijë një vlerësim të konformitetit të veprimtarisë së auditimit të

brendshëm me përkufizimin e Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve dhe një vlerësim nëse audituesit e brendshëm zbatojnë Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim.

Drejtuesi i Sektorit të AB-së komunikon me Kryetarine Bashkise, lidhur me implementimin e programit dhe sigurimin e cilësisë, duke përfshirë rezultatet e vlerësimit e vazhdueshme të brendshme dhe vlerësime të jashtme, të cilat duhet të kryhen të paktën një herë në çdo 5 vjet.

Neni 11

Bashkepunimi nderinstitucional

11.1. Marrëdhëniet me strukturën përgjegjëse të harmonizimit të AB

Drejtuesi i Sektorit të AB raporton dhe mban kontakte të rregullta me Drejtorine e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave . Në funksion të bashkërendimit të punës, ky bashkëveprim konsiston në:

- Përgatitjen e planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë së Sektorit të AB dhe dergimi i tyre në DH/AB brenda afatit të përcaktuar me ligj;
- Përcaktimin dhe zhvillimin e sistemit të raportimit të rezultateve për veprimtaritë e auditimit të brendshëm në bashkine Kucove,
- Hartimin e raportit vjetor të veprimtarisë së sektorit të AB dhe dergimi pas miratimit të tij në DH/AB në respektim të afatit të përcaktuar në ligj.
- Zhvillimin dhe zbatimin e një metodologjie efëcente për garantimin e cilësisë së veprimtarisë AB , në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar të auditimit të brendshëm;
- Evidentimin e kërkesave për trajnimin profesional të audituesve të brendshëm.
- Evidentimin e kërkesave për certifikimin e audituesve të brendshëm të bashkise Kucove.

11.2. Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit

Spektori i AB bashkëpunon me Kontrollin e Lartë të Shtetit bazuar në parimet e komunikimit të vazhdueshëm, angazhimit, mirëkuptimit dhe besimit të ndërsjellë. Drejtuesi i NjAB në bashkëpunim me audituesit e KLSH-së dhe me kërkesë të tyre, ju përcjell të gjithë informacionin që lidhet me përmbajtjen e auditimeve të brendshme të përfunduara. Audituesit e KLSH në aktivitetet e tyre do të vlerësojnë aspektet e punës së AB, të tilla si statusi i AB-së, pavarësia, cilësia dhe metodologjia e punës dhe kapaciteteve trajnuese.

Fushat kryesore të bashkëpunimit janë:

- shkëmbimi i planit të konsoliduar të auditimit, me synim shmangien e mbivendosjeve;
- shkëmbimi i informacionit dhe i raporteve të auditimit;
- zhvillimi i metodologjive të auditimit dhe trajnimi i përbashkët.

Neni 12

Standartet dhe Kuadri i Praktikave Profesionale te auditimit :

Veprimtaria dhe funksionimi i auditimit të brendshëm në Bashkine Kucove zhvillohet në pajtim me ;

- Standardet Ndërkombëtare te shpallura nga Instituti i Audituesve të Brendshëm të SHBA-së “Për praktikat Profesionale të Auditimit të Brendshëm” .
- Rregullat dhe metodologjinë e auditimit (proçedurat për planifikimin, kryerjen, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga auditimi) të përcaktuara në Manualin e Auditimit te Brendshem.
- Kerkesat e Kodit të Etikës për audituesit e sektorit publik, miratuar nga Ministri i Financave(me Urdherin nr86, datë10.12.2015) dhe rregullave të sjelljes në administratën publike.
- Dhe ne perditesim te akteve qe percjell Drejtoria e Harmonizimit te Auditimit te Brendshem ne Ministrine e Financave.

Neni 13 Shfuqizimet

Karta e Auditimit te Sektorit te Auditimit te Brendshem ne bashkine Kucove, miratuar me Urdherin e Kryetarit te Bashkise me nr.47 date 24.02.2022, **shfuqizohet**.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Karta e Auditimit te Sektorit te AB bashkia Kucove hyn ne fuqi dite e miratimit te saj .

KARTA E AUDITIMIT TE BRENDSDHEM

Miratuar me Urdherin e Kryetarit te Bashkise nr.____ date___/ 06 /2024

Drejtuasi i Njesise Auditimit te Brendshem

Adriatik CARKA

KRYETARI I BASHKISE

Kreshnik HAJDARI

